

VENDIM
Nr. 311, datë 16.4.2020

PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT TË AKOMODIMIT TË PËRKOHSHËM TË PERSONAVE QË RIATDHESOHEN SI REZULTAT I GJENDJES SË SHKAKTUAR NGA COVID-19

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 41, të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, të aktit normativ nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave për mënyrën e organizimit të akomodimit të përkohshëm të personave që riatdhesohen si rezultat i shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19 në strukturat akomoduese, të miratuara rast pas rasti me vendim të Komitetit Ndërminstor të Emergjencave Civile, sipas rregullores që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Akomodimi i përkohshëm i personave të riatdhesuar bëhet nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Brendshme.

3. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, pas evidentimit nga Shoqata Shqiptare e Turizmit (ATA) dhe Unioni Turistik Shqiptar (UTSH), përzgjedh strukturat akomoduese ku do të kryhet akomodimi i përkohshëm i personave dhe ia përcjell për miratim Komitetit Ndërminstor të Emergjencave Civile.

4. Shpenzimet e akomodimit të përkohshëm të të riatdhesuarve mbulohen një pjesë nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit dhe pjesa tjetër nga personi i riatdhesuar, sipas përcaktimeve të rregullores që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Vetëm për strukturat akomoduese, që kanë marrëveshje me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, do të kryhen pagesat nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit, sipas marrëveshjes tip, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kujdeset për shëndetin e personave të riatdhesuar dhe merr masa për respektimin e kushteve që duhet të ndiqen në përputhje me aktet ligjore/nënligjore në kuadër të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.

7. Ministria e Brendshme, nëpërmjet Policisë së Shtetit, merr masat e nevojshme për shoqërimin e personave të riatdhesuar në strukturat akomoduese dhe siguron moslargimin e tyre nga këto struktura, sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara në aktet ligjore/nënligjore në kuadër të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.

8. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme dhe Agjencia Kombëtare e Bregdetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

RREGULLORE

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT TË AKOMODIMIT TË PËRKOHSHËM TË PERSONAVE QË RIATDHESOHEN SI REZULTAT I GJENDJES SË SHKAKTUAR NGA COVID-19

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për mënyrën e organizimit të akomodimit të përkohshëm të personave që riatdhesohen si rezultat i shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19 në strukturat akomoduese.

Neni 2

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i detyrave për secilin nga institucionet/shoqatat e përfshira në këtë proces, në funksion të akomodimit të përkohshëm dhe të sigurimit të kushteve normale të jetesës për personat që riatdhesohen në strukturat akomoduese respektive.

Neni 3

Akomodimi i përkohshëm

1. Akomodimi i përkohshëm i personave të riatdhesuar do të bëhet në struktura akomoduese, të miratuara rast pas rasti me vendim të Komitetit të Ndërmintor të Emergjencave Civile, bazuar në propozimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, sipas marrëveshjes Tip bashkëlidhur vendimit.

2. Akomodimi i përkohshëm all inclusive në strukturat akomoduese, në funksion të këtij procesi, për personat e riatdhesuar përfshin:

- a) fjetje;
- b) 3 (tre) vakte ushqim;
- c) drita;
- ç) ujë;
- d) ngrohje;
- dh) siguri;
- e) pastrim;

3. Pagesa për akomodimin e përkohshëm është 2.500 lekë në ditë për person, përfshirë TVSH-në, nga të cilat 1.700 lekë paguhen nga buxheti i shtetit dhe 800 lekë nga personi i riatdhesuar, sipas vendimit të Komitetit Ndërmintor të Emergjencave Civile.

4. Vlera e pagesës, sipas përcaktimit të pikës 3, të këtij neni, nuk mund të jetë më e madhe se 2.500 lekë në ditë për person, përfshirë TVSH-në.

5. Nëse subjekti privat shpreh pëlqimin, për shkak të situatës, të ofrojë falas akomodimin e përkohshëm për disa individë brenda strukturës së tij, Agjencia Kombëtare e Bregdetit bën zbritjen nga vlera e përgjithshme e faturës.

6. Efektet financiare, sipas këtij neni, do të përballohen nga fondet të vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit.

Neni 4

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe shoqatat e hoteleve

1. Unioni Turistik Shqiptar (UTSH) dhe Shoqata Shqiptare e Turizmit (ATA) evidentojnë strukturat akomoduese/hotelet dhe listën ia përcjellin Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

2. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit bën përzgjedhjen e tyre bazuar në standardet cilësore të ndërtimit, kapacitetit të akomodimit mbi 20 dhoma si dhe eksperiencë bashkëpunimi me operatorë menaxhues të strukturave akomoduese dhe ia përcjell për miratim Komitetit të Ndërmnistror të Emergjencave Civile.

3. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit autorizon Agjencinë Kombëtare të Bregdetit për nënshkrimin e marrëveshjes me subjektet private që operojnë në fushën e hoteleri-turizmit, sipas listës së strukturave akomoduese të miratuara nga Komiteti Ndërmnistror i Emergjencave Civile.

4. Vetëm pas nënshkrimit të marrëveshjes, subjektet private do të kompensohen nga AKB-ja, nga fondet të vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit.

Neni 5

Detyrat e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit

1. AKB-ja është institucioni koordinues për verifikimin e plotësimit të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i kushteve të marrëveshjes për akomodimin e përkohshëm të personave që riatdhesohen, të lidhur ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe subjektit për akomodimin e këtyre personave nëpër struktura akomoduese, bazuar në listën e vënë në dispozicion nga subjekti i strukturës akomoduese dhe pasi të jetë përgatitur dosja personale për çdo person të riatdhesuar.

2. Agjencia Kombëtare e Bregdetit (AKB) nënshkruan marrëveshje të veçantë me secilën strukturë akomoduese, të përzgjedhur, që do të sigurojë akomodimin e përkohshëm të të personave që riatdhesohen.

3. Agjencia Kombëtare e Bregdetit siguron nga subjekti i strukturës akomoduese dosjen personale për çdo person të riatdhesuar, e cila përmban kopje të pasaportës së personit ku evidentohet data e daljes nga shteti që vjen dhe/ose kopje të biletës së udhëtimit.

4. Agjencia Kombëtare e Bregdetit, do të marrë përsipër mbulimin e shpenzimeve me fondet e buxhetit të shtetit.

Neni 6

Detyrat e ministrive

1. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale:

a) kujdeset për shëndetin e personave të riatdhesuar në momentin e mbërritjes së tyre dhe gjatë gjithë periudhës së qëndrimit në strukturat akomoduese;

b) merr masa për respektimin e kushteve të higjienës, të distancimit dhe çdo mase tjetër që duhet të ndiqen në përputhje me parashikimet e akteve ligjore/nënligjore në kuadër të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.

2. Ministria e Brendshme, nëpërmjet Policisë së Shtetit, ka këto detyra:

a) të shoqërojë personat e riatdhesuar në strukturat akomoduese në momentin e mbërritjes ose sa herë është e nevojshme;

b) merr masa për të siguruar moslargimin e personave të riatdhesuar nga strukturat akomoduese sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara në aktet ligjore/nënligjore në kuadër të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19 dhe bashkëpunon me Agjencinë Kombëtare të Bregdetit për dhënien e informacionit.

3. Në funksion të mirëorganizimit të procesit, secila ministri nxjerr udhëzime për menyrën e organizimit dhe zbatimit të këtyre parashikimeve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

AGJENCIA KOMBËTARE E BREGDETIT

Nr. _____ prot.

Datë ____/____/2020

SUBJEKTI _____

Nr. _____ prot.

Datë ____/____/201__

**MARRËVESHJE
PËR AKOMODIMIN E PËRKOHSHËM, ALL INCLUSIVE
TË PERSONAVE QË RIATDHESOHEN SI REZULTAT I GJENDJES SË
SHKAKTUAR NGA COVID-19**

NDËRMJET

AGJENCISË KOMBËTARE TË BREGDETIT

DHE

SUBJEKTIT _____

Agjencia Kombëtare e Bregdetit: institucion publik, në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, me adresë: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Pallatet Shallvare, Tiranë, Shqipëri, me numër unik identifikimi NUIS L41417451U, përfaqësuar ligjërisht në këtë marrëveshje (këtu e në vijim marrëveshja nga z. Ledion Lako, drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit (më poshtë referuar si “AKB”).

dhe

Subjektit _____, përfaqësuar nga _____, me
NIPT _____, me adresë _____,

të dyja së bashku referuar si “PALËT”,

- Bazuar në gjendjen e fatkeqësisë natyrore, të shpallur me vendimin nr.243, datë 24.03.2020, të Këshillit të Ministrave, si pasojë e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.

Bazuar në dispozitat e ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”,

Bazuar në aktin normativ nr.3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar;

si dhe duke parë nevojën për bashkëpunim dhe mirëkuptim dypalësh, në mbështetje të personave të riatdhesuar si pasojë e gjendjes së shkaktuar nga COVID-19 dhe në mirëkuptim të plotë me njëri-tjetrin, vendosën të hartojnë dhe të nënshkruajnë këtë marrëveshje si më poshtë vijon:

Neni 1
Parime të përgjithshme

1. Kjo marrëveshje synon sigurimin e ndihmës reciproke për përballimin e nevojave për akomodim, all inclusive (përfshirë strehim dhe ushqim) të personave që riatdhesohen si pasoje e gjendjes së shkaktuar nga COVID-19.

2. AKB-ja është institucioni koordinues për verifikimin e plotësimit të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i kësaj marrëveshje dhe për akomodimin e personave të riatdhesuar nëpër struktura akomoduese, bazuar në dokumentat e parashikuar në pikën 5 të këtij neni.

3. Ministria e Brendshme, nëpërmjet Policisë së Shtetit, është përgjegjëse për shoqërimin e personave që riatdhesohen në strukturat akomoduese dhe për marrjen e masave për moslargimin e tyre nga këto struktura.

4. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është përgjegjëse për shëndetin e personave të riatdhesuar dhe merr masa për respektimin e kushteve që duhet të ndiqen në përputhje me kuadrin ligjor/nëligjor në fuqi.

5. Subjekti i strukturës akomoduese është përgjegjës për sigurimin e listës së personave që riatdhesohen si dhe për përgatitjen e dosjes personale për secilin person dhe vënien në dispozicion AKB-së

6. Subjekti _____ është përgjegjës për ofrimin e akomodimit (përfshirë strehim dhe ushqim) për numrin e dakordësuar të personave sipas specifikimeve të kësaj marrëveshje.

Neni 2
Objekti i marrëveshjes

Objekti i kësaj marrëveshje është garantimi i akomodimit all inclusive (përfshirë strehimin dhe ushqimin) të personave që riatdhesohen si pasoje e gjendjes së shkaktuar nga COVID-19.

Neni 3
Kohëzgjatja

Kjo marrëveshje e lidhur midis AKB-së dhe subjektit për një periudhë kohore ____deri ____muaj, dhe i fillon efektet e saj ligjore në datën _____ dhe do të vijojë deri në datën _____. (me afat maksimal deri në datën _____).

Neni 4
Pagesa

Pagesa për akomodimin e përkohshëm të personave të riatdhesuar është 2.500 lekë në ditë për person, përfshirë TVSH-në, nga të cilat 1.700 lekë paguhen nga buxheti i shtetit dhe 800 lekë nga personi i riatdhesuar, pjesë e listës bashkëlidhur kësaj marrëveshje dhe përfshin strehimin, ushqimin për të tria vaktet, ngrohje dhe të gjitha shërbimet e tjera, përfshirë detyrimin ligjor për likuidimin mujor të energjisë elektrike dhe të ujësjellësit për gjatë gjithë periudhës që do të zgjasë kjo marrëveshje.

Neni 5
Kushtet e pagesës

1. AKB-ja do t'i paguajë subjektit _____ vlerën 1.700 lekë në ditë, për person, përfshirë TVSH-në, sipas listës bashkëlidhur të dakordësuar në këtë marrëveshje, e cila

rishikohet, sipas faturës së lëshuar nga subjekti, ndërsa pjesa tjetër prej 800 lekë paguhet nga personi i riatdhesuar.

2. Listë prezenca e personave duhet të shoqërojë faturën e lëshuar nga struktura akomoduese. Listë prezenca duhet të ketë të përcaktuar qartë datën e hyrjes dhe daljes nga hoteli të personit.

3. Kjo vlerë mbetet e pandryshuar për gjatë gjithë kohës që do të zgjasë kjo marrëveshje.

4. Pagesa do të bëhet sipas kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshje, në Bankën _____ me IBAN _____.

5. Efektet financiare për zbatimin e kësaj marrëveshje do të përballohen një pjesë nga fondet e buxhetit të shtetit dhe një pjesë nga personi që riatdhesohet.

Neni 6

Të drejtat dhe detyrimet e AKB-së

1. AKB-ja ka detyrimin të koordinojë gjithë procesin e akomodimit të përkohshëm me subjektin____, bazuar në listat e konfirmuara të personave të riatdhesuar.

2. AKB-ja është e detyruar të paguajë në masën dhe afatin e parashikuar në këtë marrëveshje për të gjithë personat e strehuar në strukturën akomoduese, bazuar në listat e parashikuara sipas pikës 5 të nenit 1 të kësaj marrëveshje.

3. AKB-ja përcjell pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, çdo 2 (dy) javë, një raport përmbledhës mbi numrin e personave/individëve të akomoduar përkohësisht në strukturën akomoduese, kushtet e jetesës dhe të ushqimeve për të strehuarit.

Neni 7

Të drejtat dhe detyrimet të subjektit_____

1. Subjekti____, menjëherë me nënshkrimin e kësaj marrëveshje, duhet të sigurojë transportin e personave të riatdhesuar sipas listave të vëna në dispozicion;

2. Subjekti _____duhet të strehojë personat e riatdhesuar, sipas listës bashkëlidhur, në dhomat e strukturës akomoduese që disponon, duke i siguruar kushte normale jetese, ujë, drita, ngrohje, siguri dhe pastrim dhe të raportojë periodikisht dhe sa herë është e nevojshme tek AKB-ja mbi lëvizjet e personave të riatdhesuar.

3. Subjekti_____ duhet të garantojë ushqimin për personat e riatdhesuar, për të tria vaktet në të gjitha ditët e qëndrimit kundrejt vlerës së pagesës të dakordësuar mes palëve.

4. Subjekti_____ duhet të paguajë të gjitha detyrimet kundrejt shtetit për pagimin e energjisë elektrike, ujë, detyrimet mujore për ambientet e përbashkëta etj.

5. Subjekti_____ merr përsipër mirëmbajtjen dhe pastrimin e sipërfaqes ku janë vendosur të strehuarit.

6. Subjekti_____ garanton AKB-në që struktura akomoduese është në posedim të rregullt ligjor dhe e ushtron atë në mënyrë të ligjshme.

7. Subjekti_____ nuk ka të drejtë ta kërkojë zgjidhjen e marrëveshjes përpara afatit të përcaktuar në marrëveshje.

Neni 8

Dispozita përfundimtare

1. Për dëmtime të qëllimshme të ambienteve dhe pajisjeve të vëna në dispozicion për të strehuarit, do të përgjigjet personalisht i strehuari sipas marrëveshjes së lidhur midis tij dhe subjektit _____.

2. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe subjekti _____ për zbatimin e kësaj marrëveshje.

3. Çdo rregullim ose ndryshim në këtë marreveshje mund të kryhet vetëm nëpërmjet pëlqimit reciprok të palëve.

4. Çdo mosmarreveshje në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj marreveshje zgjidhet me mirëkuptim midis palëve.

Neni 9

Hyrja në fuqi

1. Kjo marrëveshje do të jetë në fuqi në përputhje me përcaktimet e nenit 3, të kësaj marreveshje.

2. Kjo marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje, nga të cilat një kopje depozitohet në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, 2 (dy) kopje mbahen nga AKB-ja dhe një kopje nga subjekti.

Nënshkruar, sot më ____/____/2020.

Palët:

**AGJENCIA KOMBËTARE E
BREGDETIT**

**LEDION LAKO
DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

SUBJEKTI

